



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3026/10 prot.

Datë 19.12.2025

V E N D I M

Nr. 1887/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.12.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. **1850/2025**, datë 15.12.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrotjtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërmbëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

Ankimues: Operatori ekonomik “ISEC” SHPK me NIPT L41309004L dhe adresë Rruga Kodra e Diellit, Apartamenti 27, Shkalla 2, Kati 5, Tiranë.

BOE “ARDMIR” shpk me NIPT K82509006P & “METEO” shpk me NIPT L26310801C dhe adresë Lagjia Konizbalte”, rruga kryesore Berat.

BOE “DEHA 2010” shpk me NIPT L03425410B & “ViaNex” shpk me NIPT K87921701H dhe adresë Fshati Vajkan, zona kadastrale nr--3695 numer pasurie nr- 154/4, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mallakastër me adresë “Lagjia “18 Prilli”, Ballsh”, Mallakastër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 15.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. **1850/2025**, ku vendosi:

[...]

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ISEC” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrotjtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërmëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakaster.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Deha 2010” shpk dhe “ViaNex” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.
3. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Armdir” SHPK dhe “Meteo” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedureës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare nga BOE “Deha 2010” shpk dhe “ViaNex” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ISEC” SHPK.
8. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Armdir” SHPK dhe “Meteo” SHPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 4086/28 prot., datë 18.12.2025 me lëndë “Dërgim informacioni për vendimin nr. 1850/2025”, protokolluar me tonën me nr. 3026/7 prot., datë 19.12.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. **1850/2025**, datë 15.12.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrotjtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush,

Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërbëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën me nr. 4086/28 prot., datë 18.12.2025 me lëndë “Dërgim informacioni për vendimin nr. 1850/2025”, protokolluar me tonën me nr. 3026/7 prot., datë 19.12.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. **1850/2025**, datë 15.12.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrojtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërbëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

II.2. Referuar shkresës me nr. 4086/28 prot., datë 18.12.2025, si dhe nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin me nr. **1850/2025**, datë 15.12.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër arsyetuar autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr. **1850/2025**, datë 15.12.2025.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrojtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërbëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

